Udhëzues për Peshkopatën dhe Presidentin e Degës: Kalimi në Rekomandimin Elektronik të Tempullit

Anëtarët të cilët dëshirojnë ta kalojnë rekomandimin e tyre aktual të tempullit prej letre në një rekomandim elektronik, duhet të vihen në kontakt me një anëtar të peshkopatës së tyre ose presidentin e tyre të degës. Rekomandimi elektronik do të jetë në dispozicion në programin Mjetet e Anëtarit pasi të jenë përfunduar hapat në vijim.

Nëse anëtari/ja po rinovon rekomandimin e tij ose të saj të tempullit, fillojeni procesin e rinovimit dhe përzgjidhni mundësinë **Elektronik** për formatin e rekomandimit të tempullit që po lëshohet.

GJËRA PËR T'U DITUR:

- Një anëtar mund të ketë ose një rekomandim elektronik tempulli, ose një rekomandim në letër, por jo të dy në të njëjtën kohë.
- Nëse ndonjëri nga udhëheqësit e priftërisë që lëshoi rekomandimin aktual të tempullit të anëtarit, nuk po shërben më në atë thirrje, fillojeni procesin e rinovimit dhe përzgjidhni mundësinë **Elektronik** për formatin e rekomandimit të tempullit që po lëshohet.

Kërkesa Teknike:

- iOS 17.0 ose më i ri
- Android 8.0 ose më i ri
- Qasje në internet për konfigurimin fillestar
- Varianti 5.3 i programit Mjetet e Anëtarit ose më i ri
- Informacioni i nënshkrimit të hyrjes për programin Mjetet e Anëtarit
- Një **fotografi profili** e anëtarit/es ngarkohet në programin Mjetet e Anëtarit dhe miratohet nga një anëtar i peshkopatës së vet ose presidenti i vet i degës



Kur një anëtar kërkon ta kalojë rekomandimin e vet aktual prej letre në një rekomandim elektronik:

- Kyçuni te mjeti Burimet e Udhëheqësit dhe Nëpunësit (LCR) dhe përzgjidhni mundësinë **Tempulli** te menuja në krye.
- Përzgjidhni mundësinë **Rekomandime Tempulli** te menuja me shpalosje dhe **kërkoni anëtarin** te shiriti i kërkimit Gjej Anëtarin.
- Nën veçorinë Zgjidh një Veprim, përzgjidhni mundësinë **ndërrojeni formatin e rekomandimit aktiv nga i shtypur në letër në elektronik**.
- Nën veçorinë Rekomandim Tempulli shkoni te Formati. Përzgjidhni mundësinë **Elektronik**, më pas klikoni te **Ruaj**.

Nëse anëtari që kërkon ta kalojë rekomandimin në një rekomandim elektronik, mban aktualisht një rekomandim të lëshuar nga blloku i rekomandimeve të tempullit, së pari, intervistojeni anëtarin dhe lëshoni një rekomandim të shtypur në letër nëpërmjet mjetit LCR. Më pas, ndiqni hapat më sipër.

KISHA E JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME

© 2025 by Intellectual Reserve, Inc. All rights reserved. Varianti: 1/25. Përkthimi i "Bishopric and Branch President Guide: Switching to Mobile Temple Recommend". Albanian. PD80049902 101. Shtypur në SHBA.